

VENDIM
Nr. 713, datë 16.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE DHE QENDRËS
KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
FESTIVALIT TË 13-TË TË FILMIT SHQIPTAR, FESTIVALIT MBARËKOMBËTAR
TË DRAMËS SHQIPE DHE REALIZIMIN E DRAMËS FITUESE, SHPALLUR NË
KONKURSION ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

(Ndryshuar m VKM nr. 798, datë 14.11.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Institucioneve të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:*
 - a) *Ministrisë së Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve t’i shtohet fondi në shumën 10 371 200 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizimin e dramës fituese, shpallur në konkursin me rastin e 100 - Vjetorit të Pavarësisë.*
 - b) *Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në artikullin 604, “Projekte”, t’i shtohet fondi 5 475 000 (pesë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar.*
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha